



Republika e Kosovës - Republic of Kosovo
Komuna – Municipality
Hani i Elezit



05/ Nr/ 4602 / 2021

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitet të Republikës së Kosovës nenit 5 shkronja b), në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2013 për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës, si dhe në pajtim me udhëzimet dhe/ose procedurat dhe standardet e përgjithshme të shpallura nga MASHTI: Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, Hani i Elezit shpall;

KONKURS

Për Regjistrimin e Nxënësve në klasën e dhjetë (10) në Shkollën e Mesme të Lartë "DARDANIA" për vitin shkollor 2021/2022

Nr	Emri i shkollës	Numri i paraleleve	Nr.inxë nësve	Profili (drejtimi)	Gjithsejt ë
1	SHML "Dardania" Hani i Elezit	1	32	Shoqëror-Gjuhësor	32
		2	64	Shkencat Natyrore	64

Kushtet dhe kriteret i keni të bashkangjitur në Referencën nr 3-1046 të datës 25.06.2021 të dërguar nga MASHTI.

Afati i paraqitjes së dokumentave për vitin shkollor 2021/2022 bëhet prej datës 28,29,30 06.2021 në lokalet e shkollës duke filluar prej ora 09.00 deri ora 16.00.

Shpallja e rezultateve bëhet më 01.07.2021

- Shpallja e Konkursit për vendet e lira bëhet më 23.08.2021.
- Dorzimi i dokumenteve për konkurs plotësues bëhet më datat: 23,24,25 gusht 2021.
- Shpallja e rezultateve bëhet më 26.08.2021.
- Arsyetim: Kriteret e aplikimit dhe pranimit bëhen sipas kriterëve të MASHTI-it me nr. protokoli 1046 të datës 25.06.2021.

Data:28.06.2021
Hani i Elezit

Drejtori i DAKRS-s Hani i Elezit
Menduh Vashi

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
MINISTARSTVO OBRAZOVANJA, NAUKE, TEHNOLOGIJE I INOVACIJE
MINISTRY OF EDUCATION, SCIENCE, TECHNOLOGY AND INNOVATION
SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR

Njësia Org. _____
Org. Jedinica _____
Org. Unit _____
Nr. i faqeve _____
Br. stranica _____
No. pages _____

Nr. Prot. _____
Broj Prot. _____
Prot. No. _____
Data: _____
Datum: _____
Date: _____

3 1046 25/06/2021

Prijetinë / a _____



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

25.06.2021

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:	3-1046
PËR/ZA/TO:	Drejtoritë Komunale të Arsimit
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Znj. Fadile Dyla, zv. sekretare e përgjithshme.
NGA/OD/FROM:	Agim Berdyna, drejtor i departamentit të AP Lah Nitaj, drejtor i departamentit të AAP
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Kushtet dhe kriteret e regjistrimit të nxënësve në klasën e dhjetë (10) në gjimnaze dhe Institucionet e Arsimit dhe Aftësimin Profesional (IAAP)

Të nderuar,

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit sipas planit dinamik të punës për mbarrëvajtjen e përfundimit të vitit shkollor 2020-2021 dhe përgatitjeve për fillimin e vitit të ri shkollor 2021/2022, njofton se konkursi për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në arsimin e mesëm të lartë për vitin shkollor 2021-/2022, do të publikohet nga Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA).

Shkollat duhet të përgatiten për pranimin e dokumentacionit nga nxënësit aplikues, duke dezinfektuar ambientet shkollorë dhe duke respektuar masat e përcaktuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publike të Kosovës (IKSHPK).

Obligimet e DKA- ve ndaj MASHTI janë:

- Planifikimi duhet të dorëzohet në MASHTI për të dy afatet (konkursi për afatin e parë dhe të dytë)
- Kërkesat për drejtime dhe profile duhet të bëhen në MASHTI (zyrat përkatëse).

- MASHTI do të bëjë monitorimin e procesit të regjistrimit dhe pranimit të nxënësve
- DKA-të do të formojnë komisionet profesionale përkatëse për regjistrimin dhe pranimin e nxënësve

Në vijim planifikimi i MASHTI, kriteret dhe kushtet për regjistrim për vitin shkollor 2021/2022:

- Shpallja e konkursit më datë 28.06.2021 nga DKA-të
 - Dorëzimi i dokumenteve më 28, 29 dhe 30 qershor 2021
 - Shpallja e rezultateve më 01.07.2021
 - Shpallja e konkursit plotësues për vendet e lira bëhet me datë 23.08.2021
 - Dorëzimi i dokumenteve për konkurs plotësues bëhet në datat 23, 24 dhe 25 gusht 2021.
 - Shpallja e rezultateve për konkurs plotësues bëhet me dt. 26.8.2021
- Konkursi duhet të shpallet edhe në gjuhët e komuniteteve në komunat ku organizohet mësimi në dy e më shumë gjuhë.

Konkursi shpallet duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës dhe Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin Profesional si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013, për Numrin maksimal të nxënësve për klasë dhe raportin mësimdhënës nxënës.

Kushtet dhe kriteret:

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në gjimnaze dhe IAAP, për vitin shkollor 2021/2022, mund të konkurrojnë nxënësit, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë përfunduar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe më pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe IAAP, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron).
- Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- Certifikatën e lindjes.

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe IAAP për vitin shkollor 2021/2022, bëhet në datat 28, 29 dhe 30 qershor 2021, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 01.07.2021. Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej datës 02.07.2021. Nxënësi i refuzuar i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit, ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve ti parashtroj ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme komisionit për ankesa në MASHTI.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (40%) 40 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (20%) 20 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (40%) 40 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë 4 (Së pari llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6,7,8,9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

- Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.
- Lëndët me prioritet në sukses sipas drejtimeve të gjimnazeve
 - a. Gjimnazi i shkencave natyrore: Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë
 - b. Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore: Gjuhë amtare, Gjuhë angleze. Histori, Gjeografi

Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP

- a. Shëndetësi, Bujqësi, Teknologji Ushqimore, dhe Veterinari: Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Fizikë, Gjuhë angleze
- b. Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi – Teknologji, PTT: Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë
- b. Ekonomi, Administratë, : Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi
- c. Juridik: Gjuhë shqipe dhe letërsi, Edukatë qytetare, Histori, Gjuhë angleze
- d. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm: Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze, Shkenca shoqërore, Matematikë dhe Informatikë, Shkenca natyrore
- e. Shkollat Artistike: Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze, Shkenca shoqërore, Matematikë dhe Informatikë, Shkenca natyrore
- f. Drejtimi pedagogjik – profili bashkëpunëtor muzikor: Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar; Drejtimi instrumental: Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII); Në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI). Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë – duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

3. Kriteri i suksesit të notave në lëndët prioritare për drejtimet përkatëse:

- Gjimnazi i shkencave natyrore - Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji dhe matematikë së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndet fizikë, kimi dhe biologji),
- Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore - Mesatarja e lëndëve: gjuhë shqipe, gjuhë angleze, histori, gjeografi, së paku duhet të jetë 4 (katër) si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndët histori, gjeografi dhe ed. qytetare)
- Shkollat e Shëndetësisë - Mesatarja e lëndëve: fizikë, kimi, biologji dhe gjuhë amtare së paku duhet të jetë 4 (katër), si dhe 40% të pikëve nga lëndët prioritare në test (10 pikë nga lëndet fizikë, kimi dhe biologji),

B. Përmbajtja e testit – numri i kërkesave (pyetjeve) sipas lëndëve:

I. Gjuhë

- | | | |
|------------------|---------|--------------------|
| 1. Gjuhë shqipe | 20 pikë | |
| 2. Gjuhë angleze | 5 pikë | (Gjithsej 25 pikë) |
- II. Shkencat shoqërore:
- | | | |
|--------------|---------|--------------------|
| 1. Gjeografi | 12 pikë | |
| 2. Histori | 13 pikë | (Gjithsej 25 pikë) |
- III. Matematikë
- | | | |
|----------------|---------|--------------------|
| 1. Matematikë | 20 pikë | |
| 2. Informatikë | 5 pikë | (Gjithsej 25 pikë) |
- IV. Shkencat natyrore:
- | | | |
|-------------|--------|--------------------|
| 1. Fizikë | 8 pikë | |
| 2. Kimi | 8 pikë | |
| 3. Biologji | 9 pikë | (Gjithsej 25 pikë) |

4. Renditja e lëndëve me prioritet në test sipas drejtimeve të gjimnazeve:

I. Gjimnazi shkencat e natyrës:

- | | |
|--------------------------------------|----------------------------|
| 1. Shkencat e natyrës 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Matematikë dhe Informatikë 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkencat shoqërore 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | Totali = 40 pikë |

II. Gjimnazi shoqëror dhe gjuhësor:

- | | |
|--------------------------------------|----------------------------|
| 1. Shkenca shoqërore 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |
| 4. Shkenca natyrore 25 | $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë |
| | Totali = 40 pikë |

1. Renditja e lëndëve me prioritet sipas profileve në IAAP

I. Shëndetësi, Bujqësi dhe Veterinari

- | | |
|--------------------------------------|----------------------------|
| 1. Shkencat natyrore 25 | $25 \times 0.8 = 20$ pikë |
| 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 | $25 \times 0.4 = 10$ pikë |
| 3. Matematikë dhe Informatikë 25 | $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë |

4. Shkencat shoqërore 25 $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë
Totali = 40 pikë

II. Makineri, Elektroteknikë, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë dhe Komunikacion, Kimi – Teknologji

1. Matematikë dhe Informatikë 25 $25 \times 0.8 = 20$ pikë
 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
 3. Shkenca natyrore 25 $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
 4. Shkenca shoqërore 25 $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë
Totali = 40 pikë

III. Ekonomi

1. Matematikë dhe informatikë 25 $25 \times 0.8 = 20$ pikë
 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
 3. Shkenca shoqërore 25 $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
 4. Shkencat natyrore 25 $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë
Totali = 40 pikë

IV. Juridik

1. Shkencat shoqërore 25 $25 \times 0.8 = 20$ pikë
 2. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
 3. Matematikë dhe Informatikë 25 $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
 4. Shkenca natyrore 25 $25 \times 0.2 = 5$ pikë
Totali = 40 pikë

V. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.8 = 20$ pikë
 2. Shkenca shoqërore 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
 3. Matematikë dhe Informatikë 25 $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
 4. Shkenca natyrore 25 $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë
Totali = 40 pikë

VI. Shkollat Artistike

1. Gjuhë amtare dhe gjuhë angleze 25 $25 \times 0.8 = 20$ pikë
 2. Shkenca shoqërore 25 $25 \times 0.4 = 10$ pikë
 3. Matematikë dhe Informatikë 25 $25 \times 0.3 = 7.5$ pikë
 4. Shkenca natyrore 25 $25 \times 0.1 = 2.5$ pikë
Totali = 40 pikë

VII. Kriteret specifike për regjistrimin në shkolla të muzikës

- a. Drejtimi pedagogjik – profili bashkëpunëtor muzikor:
 Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe testin kombëtar;
- b. Drejtimi instrumental:

Nxënësi duhet ta ketë të përfunduar shkollimin e obliguar (kl. IX) dhe shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VII);

c. Në klasën e VII të shkollës së muzikës mund të regjistrohen vetëm nxënësit që kanë përfunduar shkollën e ulët të muzikës (kl.I-VI).

e. Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë – duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt në Gjimnazin e Specializuar Matematikor në Prishtinë

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në Gjimnazin e Specializuar Matematikor, për vitin shkollor 2021/22, mund të konkurrojnë vetëm nxënësit e shkëlqyeshëm, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Kandidatët që konkurrojnë kanë të drejtë të jenë nga të gjitha komunat e Kosovës, të cilët konsiderojnë se kanë prirje për Matematikë.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në këtë Gjimnaz, duhet të paraqesin këto dokumente:

- Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollë)
- Dëftesën e fotokopjuar për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) , nëse Konkursi shpallet në të njëjtën kohë me shkollat tjera- në të kundërtën origjinalet dhe
- Ekstraktin e lindjes.

3. Kriteret për regjistrim

Të gjithë nxënësit që do të regjistrohen në klasën e dhjetë – duhet t'i nënshtrohen provimit pranues nga komisioni i shkollës.

- Kandidatët kanë të drejtë të jenë nga të gjitha komunat e Kosovës, të cilët konsiderojnë se kanë prirje për Matematikë.

- Kandidatë do t'i nënshtrohen Provimit Pranues.

- Provimi pranues përgatitet, kontrollohet nga mësimdhënës të Autorizuar nga shkolla.

- Kandidatët mund të mos i tërheqin dokumentet nga shkollat ku janë pranuar. Mjafton të sjellin dëshmitë e fotokopjuara. (Nëse Konkursi është shpallur në të njëjtën kohë)

- Kandidatët në rangim mund të arrijnë maksimalisht 100 pikë të shpërndara si vijon:

1. Suksesi i Përgjithshëm nga Shkolla e mesme e ulët 20 pikë (20%);
Për secilën nga klasat 6,7,8,9

- Për sukses të Shkëlqyeshëm merr nga 5 pikë;
- Për sukses Shumë të mirë merr nga 4 pikë
- 2. Sukses nga Lënda e Matematikës në Shkollën e mesme të ulët maksimumi 20 pikë. Për secilën nga klasat 6,7,8,9
 - Për notën 5 në Matematikë merr 5 pikë;
 - Për notën 4 në Matematikë merr 4 pikë;
- 3. Sukses nga Testi i Arritshmërisë nga lënda e Matematikës, maksimumi 20 pikë;
- 4. Sukses i Provimit Pranues –maksimumi 40 pikë.

Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për Gjimnazin e Specializuar Matematikor, për vitin shkollor 2021/22, bëhet prej datës 28-29-30 - 2021 në lokalet e shkollës amë, duke filluar nga ora 9.00-16.00.

Provimi pranues me datën 01.07.2021 në ora 10.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollën përkatëse me datën 02.07.2021.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 05.07. 2021.